



**AGJENCIA E KOSOVËS PËR AKREDITIM
KOSOVO ACCREDITATION AGENCY
AGENCIJA ZA AKREDITOVANJE KOSOVA**

Student's Center, 2nd floor, 10000 Prishtina, Kosovo, tel. +381 38 213722, fax +381 38 213087
www.akreditimi-ks.org, email: kaaoffice@gmail.com

Nr. 740/14 Dt. 03.03.2014

Në mbështetje të nenit 145, paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4,21,22 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189), neni 7 (pika 2.3 dhe 4) neni 15 (pika 1, 2 dhe 3) të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037), Udhëzimit Administrativ për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë (Nr. 25/2012), Udhëzimit Administrativ për Themelimin e Agjencisë së Akreditimit të Kosovës (Nr. 11/2004), Udhëzimit Administrativ mbi Kriteret dhe Procedurat për Akreditimin e Shkollave të Larta Profesionale dhe Shkollave të Larta Teknike në Republikën e Kosovës (Nr. 12/2009), dhe Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë, mori:

V E N D I M

I. Akreditohet programi i studimit i SHLP "QEAP Heimerer":

- Menaxhimi i Institucioneve dhe Shërbimeve Shëndetësore /MSc

për periudhën 3 vjeçare, 1 Tetor 2014 – 30 Shtator 2017.

A r s y e t i m

II. Duke u mbështetur në dispozitat e shënuara më lartë, rekomandimet dhe sqarimet shtesë të dhëna nga ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

III. Ndaj këtij vendimi lejohet kërkesa për rishqyrtim të vendimit të KSHC-së brenda afatit të paraparë ligjorë.

IV. Institucioni i juaj është i obliguar që të hartojë një Plan të Përmirësimit në bazë të rekomandimeve të dhëna nga Ekipi i Ekspertëve (në të dy gjuhët, shqip dhe anglisht dhe në të dy versionet, të shtypur dhe elektronik në CD) dhe të njëjtin ta dorëzoni në Agjencinë e Kosovës për Akreditim deri më 30 Tetor 2014.

V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- SHLP "QEAP Heimerer"
- Arkivit të AKA-së



F. Etemi
Dr.sc. Ferdije Zhushi Etemi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë